




Partia
Demokratike



PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Tiranë, më ___ / 05 / 2025

Lënda: KËRKESË PËR INFORMACION DHE EKSPERTIM TË PAVARUR
MBI MATERIALET ZGJEDHORE TË KAPURA NË PEQIN, QARKU
ELBASAN, MË DATË 22.05.2025

Nga subjekti: PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË
MADHËSHTORE (PD-ASHM)

Baza Ligjore: Kushtetuta e RSH; Neni 123/1 e vijues i Kodit Zgjedhor.

Drejtuar:

- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Përfaqësuar nga z. Ilirjan Celibashi.
- Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan.

Në vemëndje të: OSBE-ODIHR, prezenca në Shqipëri

Të nderuar,

Në lidhje me ngjarjen e bujshme të datës 22 Maj 2025 në qytetin e Peqinit, ku falë reagimit të menjëhershëm të kandidatit për deputet të PD-ASHM në Qarkun Elbasan u bë i mundur identifikimi dhe dokumentimi i pranisë së **materialeve zgjedhore** në një ambient privat, përfshirë:

- Fletë votimi që për sy të lirë janë të padallueshme nga fletët e votimit origjinale të përdorura në procesin zgjedhor të datës 11 maj 2025;
- Lista zgjedhësish me vulë të njomë, badge akreditimi të KQZ-së, dokumenta identifikimi, si dhe shuma të konsiderueshme parash,

si dhe duke marrë shkas nga publikimi sot më datë 23 maj 2025 në disa media të lajmit me titull “*Policia përgënjeshtroi Sali Berishën: Fletët e votimit të gjetura në Peqin, të falsifikuara*”, kërkojmë zyrtarisht nga institucionet tuaja të na vihet në dispozicion sa vijon:

1. Informacion zyrtar nëse është kryer ndonjë ekspertizë shkencore, kriminalistike apo laboratorike mbi materialet e sekuestruara më 22 maj 2025 në Peqin, konkretisht mbi fletët e votimit të dyshuara, listat zgjedhore, badge-et e akreditimit dhe çdo material tjetër të lidhur me procesin zgjedhor të gjendura aty;

2. Nëse ekspertiza është kryer, **cili laborator apo institucion ka kryer analizimin e tyre dhe cilat janë konkluzionet** e kësaj ekspertize;
3. Në funksion të transparencës dhe interesit publik, **të bëhet publike kjo ekspertizë**, bashkë me raportin teknik përkatës;
4. PD-ASHM **kërkon zyrtarisht kryerjen e një ekspertize shtesë, të pavarur, nga një institucion vendas ose nga një institucion ndërkombëtar i besueshëm**;
5. Kërkojmë gjithashtu nga KQZ dhe organet e ligjzbatuese **një informacion të detajuar lidhur me faktin nëse ndonjë prej këtyre fletëve është gjetur apo gjenden në kutitë e votimit, brenda Qarkut Elbasan apo jashtë tij.**

Nisur nga rëndësia e rastit, kërkojmë që kjo çështje të trajtohet nga institucionet tuaja me prioritet absolut dhe transparencë të plotë.

Në pritje të përgjigjes suaj zyrtare dhe veprimeve përkatëse,

Me respekt,

Franci NURI

Përfaqësues Ligjor i PD-ASHM pranë KQZ



Policia përgënjeshtroi Sali Berishën: Fletët e votimit të gjetura në Peqin, të falsifikuara

Kreu i PD-së, Sali Berisha denoncoi ditën e djeshme një rast si të dyshuar për krime zgjedhore në Peqin. Pas këtij pretendimi të Berishës policia njoftoi sot se ka sekuestruar 10 fletë votimi të falsifikuara në një lokal fshatin Pekisht, Peqin.



[Sh]
.com

Redaksia
23 Maj, 10:59 | Përditesimi: 23 Maj, 15:05

f Share

A A



Peqin- Kreu i PD-së, Sali Berisha denoncoi ditën e djeshme një rast si të dyshuar për krime zgjedhore në Peqin, sipas tyre të manipulimit të votave përmes të ashtuquajturit “treni bullgar”.

Pas këtij pretendimi të Berishës policia njoftoi sot se ka sekuestruar 10 fletë votimi të falsifikuara në një lokal fshatin Pekisht, Peqin.

Në njoftimin zyrtar për mediat bëhet me dije se ka nisur hetimi në gjendje të lirë për pronarin e lokalit, Dervish Beqiri.



LEXO EDHE:

Sefa për 'Studio Live': PD s'ka prova për vjedhje të zgjedhjeve, po mbron Berishën që të mos ikë! 'Lotë krokodili' për Alimehmetin, nëse u vjen keq Noka e Këlliçi t'i lënë vendin e tyre

Gjatë kontrolleve të kryera atij iu sekuestruan gjithashtu 280 000 lekë, ndërsa në banesë iu gjet një pushkë e vjetër trofe dhe një pistoletë zhurmuese (sportive).

Njoftimi i policisë:

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Peqin, pas njoftimit të marrë më datë 22.05.2025, se në një lokal në fshatin Pekisht, ishin gjetur disa materiale të dyshuara zgjedhore, kanë shkuar menjëherë në adresën e dhënë, me qëllim verifikimin e rastit.

Gjatë veprimeve të kryera në vendngjarje, në bashkëpunim me Prokurorinë e Elbasanit, në lokalin e shtetasit D. B., janë gjetur dhe sekuestruar 10 fletë të ngjashme me fletët e votimit, të paplotësuara, të dyshuara të falsifikuara, si dhe një listë emërore e zgjedhësve. Gjithashtu, është sekuestruar portofoli i shtetasit D. B., me 280 000 lekë.

Më tej, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit D. B., janë gjetur një pushkë e vjetër trofe dhe një pistoletë zhurmuese (sportive).

Në vijim të veprimeve për rastin, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Peqin referuan materialet procedurale në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin D. B., për veprat penale "Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme hetimore.

lajm ne perditessim...

Nje det me oferta te pret...

zbulo me teper ne booking.adriaferries.com



Xh.K/SI.E./Shqiptarja.com

TAG:

peqin

Elbasan

flete votimi

dervish beqiri

sali berisha